



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr 42-400-22830 dt. 29.06 2020

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr. 03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19332, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullorës MF-NR 04/2017, Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr12.nr.400-37743 të datës 03.07.2018 Për plotësim ndryshimin e Rregullores nr12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, si dhe Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me date **29.06.2020**, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT OJQ „Shqipet e Drenicës”

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin OJQ „Shqipet e Drenicës”. Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktivitetit për vitin 2020.

Neni 2.

Projekti i OJQ „Shqipet e Drenicës”, përkrahet me shumën prej **2,500.00€ (dy mijë e pesëqind euro)**, mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të OJQ-së për vitin 2020.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS-së nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe tranfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/200/0000/0820

Neni 4.

Mjetet financiare barten ne konton e OJQ „Shqipet e Drenicës”. Drejtoria për Kulturë, Rinis dhe Sport është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ „Shqipet e

Drenicës”, që të bëj raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Për monitorimin dhe zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës së Drenasit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Drenasit si dhe nënshkrimi nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Labinot Halilaj